

4. Kriteret minimale sipas fushave të studimit :

(Nota mesatare paraqet kriter minimal për aplikim)

FAKULTETI	Nota Mesatare
1. Fakulteti i Arteve	9.0
2. Fakulteti i Shkencave Sportive	9.0
3. Fakulteti Juridik.....	8.0
4. Fakulteti Ekonomik	8.0
5. Fakulteti Filozofik.....	9.0
6. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.....	7.0
7. Fakulteti Filologjik.....	9.0
8. Fakulteti i Ndërtimitarisë.....	7.5
9. Fakulteti i Arkitekturës.....	7.5
10. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës	7.0
11. Fakulteti i Edukimit.....	9.0
12. Fakulteti i Mjekësisë.....	8.0
13. Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore.....	7.0
14. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike.....	8.0

5. Kriteret e vlerësimit :

1. nota mesatare mbi 9 (*nëntë*) vlerësohet me 30 pikë,
2. nota mesatare mbi 8 (*tetë*) vlerësohet me 20 pikë,
3. nota mesatare mbi 7 (*shtatë*) vlerësohet me 15 pikë,
4. studentët në asistencë sociale vlerësohen me 20 pikë,
5. studentët që studiojnë në lëndët deficitare vlerësohen me 15 pikë,
6. dy ose më shumë studentë në familje vlerësohen me 10 pikë,
7. ai/ajo, që nuk ka prindër në jetë, vlerësohet me 10 pikë,
8. studentët me nevoja të veçanta vlerësohen me 10 pikë.

Shënim: Kriteret e vlerësimit përdoren për renditjen e kandidatëve që plotësojnë kriteret minimale.

Në rast të pikëve të barabarta, përparësi kanë:

- Studentët e familjeve të dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të luftës;
- Studentët e viktimat civile të luftës;
- Studentët nga zonat rurale mbi 15 km larg.

6. Dokumentet e domosdoshme për aplikim:

1. Formulari i aplikimit (e gjeni të publikuar bashkë me thirrjen ose merret në zyrën pritëse në objektin e Komunës së Fushë-Kosovës);
2. Kopja e ID-së së studentit;
3. Vërtetimi se studenti ka regjistruar vitin akademik 2025/2026 (*origjinale*);
4. Certifikata e notave (*origjinale*);
7. Kopja e letërnjoftimit;
8. Konfirmimi i xhirollogarisë bankare.

Shtesë sipas kategorive :

- Studentët në asistencë sociale : vërtetim zyrtar;
- Studentët pa prindër : certifikata e vdekjes;
- Studentë të një familjeje : dëshmi certifikata e bashkësisë familjare;
- Studentët me nevoja të veçanta : vendim nga organet kompetente;
- Trajnerë : licenca, projekt-propozim dhe projekt-buxheti (i gjeni të publikuara bashkë me thirrjen ose merren në zyrën pritëse në objektin e Komunës së Fushë-Kosovës);

7. Afati dhe mënyra e aplikimit

Data e njoftimit të thirrjes : **01.04.2026**

1. Afati i aplikimit është 15 ditë, nga **02.04.2026** deri më **16.04.2026**.
2. Aplikimi bëhet në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Fushë-Kosovës;
3. Aplikimet e pakompletuara dhe jashtë afatit nuk shqyrtohen.
4. Kandidatëve të cilëve iu ndahet ndihma momentale do të nënshkruajnë kontratë të veçantë, ku përcaktohen të drejtat dhe obligimet.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim

Adriatik Zeqiri